



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

APS.nr.37/2020

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – DEPARTAMENTI SPECIAL**, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari Kreshnik Radoniqi si Kryetar i kolegjit, dhe gjyqtarët Burim Ademi dhe Milan Bigović, si anëtar të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bajram Rexhahmetaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit D.T. nga fshati ..., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje krime lufte kundër popullatës civile e paraparë dhe e dënueshme me nenin 142 nën ndërlidhje me nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), të datës 28 shtator 1976 dhe aktualisht me nenin 152 par.2.2 lidhur me nenin 31 të KPK-së, së bashku me nenin 3 (c) i përbashkët për Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949 neni 4 (2) (e) dhe (g) dhe (13) të protokollit II të datës 08 qershor 1977, shtojcë e konventave të Gjenevës së vitit 1949 si dhe ligjeve dhe normave të ligjit ndërkombëtar zakonor dhe veprës penale në bashkëkryerje ka kryer veprën penale krime lufte kundër popullatës civile, e paraparë dhe e dënueshme me nenin 142 nën ndërlidhje me nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ) të datës 28 shtator 1976 dhe aktualisht me nenin 152 par.2.2 lidhur me nenin 31 të KPK-së, së bashku me nenin 3 (c) i përbashkët për Konventat e Gjenevës të dt.12 gusht 1949, neni 4 (e), (8) dhe 3 (c) dhe 13 të protokollit II të datës 08 qershor 1977, shtojcë e Konventave të Gjenevës së vitit 1949 si dhe ligjeve dhe normave të ligjit ndërkombëtar zakonor, duke vendosur sipas ankesave të mbrojtësve të akuzuarit D.T. av. L.P. dhe D.V. dhe përgjigjen në ankesë nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, të parashtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.35/18 te datës, 22.06.2020, pas mbajtjes së seancës së kolegjit me datë 16.11.2020, i përpiluar me datë 30.11.2020, me shumicë votash mori këtë:

### A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** pjesërisht ankesa e mbrojtësve të akuzuarit D.T., dhe **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.35/18 te datës, 22.06.2020, vetëm sa i përket cilësimit juridik dhe vendimit mbi dënim, ashtu që:

I akuzuari **D.T.** me shënime personale si në shkresa të lëndës:

## ËSHTE FAJTOR

I. Sepse ndërmjet datës 25 – 27 mars të vitit 1999, në lagjen e njohur si lagjja “H.” ..., Komuna e Prizrenit, në cilësinë e tij si pjesëtar i forcave rezervë të policisë të Republikës Federative të Jugosllavisë (MPB), apo forcave para ushtarake serbe dhe në bashkëkryerje me kryerësit të tjetër të cilët ju përkisnin forcave të MPB-së, identiteti i të cilëve nuk u arrit të përcaktohej, mori pjesë në konfiskim të pasurisë, plaçkitje, shkatërrim të paligjshëm dhe të qëllimshëm të pasurisë (djegje e shtëpive) dhe vjedhjen në shkallë të gjer të pasurisë, e që nuk justifikohet me nevojat ushtarake, e që rezultojë në djegien e shtëpive, marrjen e automjeteve, makinerive bujqësore dhe sendeve të tjera me vlerë që i përkisnin K.H., sikurse edhe anëtarëve tjerë të familjes H., veprime këto që përbëjnë vepër penale të plaçkitjes, shkatërrimit të qëllimshëm që nuk justifikohet me nevoja ushtarake sikurse edhe sulmit të rëndë dhe mizor ndaj dinjitetit njerëzor.

II. Se ndërmjet 26 marsit dhe 27 marsit të vitit 1999 në përgjithësi, në cilësinë e tij si pjesëtar i forcave rezervë të policisë të Republikës Federative të Jugosllavisë (MPB) apo forcave paraushtarake serbe dhe në bashkëkryerje me kryerësit tjetër të cilët u përkisnin forcave të MBP-së, mori pjesë në përdhosjen e trupave të pajetë të një numri personash të paidentifikuar duke i djegur ata trupa të pajetë në mënyrë të paligjshme dhe/ose duke kërkuar shkatërrimin e tyre duke i hedhur ata trupa në mënyrë të pahijshme në lumin Dri, në një vend që ndodhet jashtë fshatit ..., Komuna e Prizrenit, akt ky që përbën sulm të rëndë dhe/ose mizor ndaj dinjitetit personal dhe njerëzor.

**Me këtë në bashkëkryerje ka kryer veprën penale *krime lufte kundër popullatës civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (LPRSFJ) të datës 28 shtator 1976, e lidhur me nenin 3 (c) i përbashkët për Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949, neni 4 (2) (e) dhe (g), (8) dhe 3 (c) dhe 13 të protokollit II të datës 08 qershor 1977, shtojcë e Konventave të Gjenevës.***

Në mbështetje të dispozitave ligjore neni 365 të KPP-së dhe nenit 22, 33, 34, 38, 41, 50 dhe nenit 142 të Kodit Penal KPRSFJ,

## E GJYKON

Me dënim me burg në kohëzgjatje prej **11 (njëmbëdhjetë) viteve**, në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 22.11.2017 e tutje.

**II.** Pjesa tjetër e aktgjykimit mbetet e pandryshuar.

## A r s y e t i m

## ***I. Objekt shqyrtimi në gjykatën e Apelit.***

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Krimeve të Rënda me aktgjykimin PKR.nr.35/18 të dt. 22.06.2020, të akuzuarin D.T. e ka shpallur fajtor për dy vepra penale të kryera në bashkëkryerje krime lufte kundër popullatës civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (ish LPRSFJ) dhe aktualisht e sanksionuar kjo vepër me Kodin Penal me nenin 152 par.2.2 lidhur me nenin 31 të KPK-së, së bashku me nenin 3 (c) i përbashkët për Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949, neni 4 (2), (e) dhe (g) dhe 13 të Protokollit II të 8 qershorit 1977 si shtojcë e Konventave të Gjenevës dhe ligjeve dhe normave të ligjit ndërkombëtar zakonor, si dhe për veprën penale krime lufte kundër popullatës civile paraparë dhe e dënueshme me nenin 142 lidhur me nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (ish KPRSFJ) dhe aktualisht me nenin 152 paragrafi 2.2 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Kosovës së bashku me nenin 3 (c) i përbashkët për Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949 neni 4 (e), (8) dhe (3), (c) dhe (13) të Protokollit II të 8 qershorit 1977 si shtojcë e Konventave të Gjenevës të vitit 1949 si dhe ligjeve dhe normave të ligjit ndërkombëtar zakonor.

Për veprën penale nën pikën I të dispozitivit i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) vitesh, për veprën penale nën pikën II të dispozitivit i ka shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) vitesh. Bazuar në nenin 80 të akuzuarit gjykata i ka shqiptuar dënimin unik me burgim prej 22 (njëzetedy) vitesh, në të cilin dënim llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.22.11.2017 e tutje.

Ka obliguar të akuzuarin që për shpenzimet e procedurës të paguajë paushallin gjyqësor në lartësi prej 2000 € (dymijë euro) dhe për fondin e kompensimit të viktimave të krimit shumë prej 50 € (pesëdhjetë) euro, të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të dëmtuarin K.H. respektivisht familjen H. për realizimin e kërkesës pasurore juridike e ka udhëzuar në kontest të rregullt në procedurën civile.

## ***Palët ankuese dhe përgjigjet në ankesë***

Mbrojtësit e të akuzuarit D.T. av. L.P. dhe D.V. kanë parashtruar ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënim dhe shpenzimet e procedurës, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën dhe aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë në atë mënyrë që i akuzuari të lirohet nga aktakuza, sepse nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale, apo që aktgjykimin ta anulojë dhe lëndën të ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Prokuroria Speciale me përgjigje në ankesë PPS.nr.149/2019 të dt.01.09.2020 sipas së cilës propozon që ankesa e mbrojtjes të refuzohet si e pabazuar, duke vlerësuar se aktgjykimi nuk

ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të kodit penal, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin dhe shpenzimet e procedurës.

Prokuroria e Apelit e Kosovës në Prishtinë me shkresën PPA/I.nr.381/20 të dt. 28.10.2020 ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësve të akuzuarit D.T. dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata ka caktuar seancën e kolegjit në mbështetje të nenit 390 të KPP-së, në të cilën seancë kanë prezantuar Prokurori i Apelit, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij av. L.P. si dhe përkthyesja e gjykatës Mizafere Halimi. Ndërsa, nuk kanë prezantuar i dëmtuari K.H. si dhe mbrojtësi i të akuzuarit av. D.V., të cilët janë ftuar në mënyrë të rregullt për kohën e mbajtjes së seancës.

Pretendimet ankimore nga mbrojtja e të akuzuarit theksohen:

a) *Për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 pika 2.1 lidhur me nenin 361 par.1*, gjë që mbrojtja thekson se pjesa më e madhe të arsyeve të aktgjyimit të ankimuar është citim i pjesëve të dëshmimeve të dëshmitarëve, që janë dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor e që është e kuptueshme, pasi që si mjet i vetëm provues në këtë lëndë ishin dëshmitarët, por gjykata e shkallës së parë po të kishte përdorur dhe analizuar në mënyrë korrekte dëshmitë e dëshmitarëve arsyet e aktgjyimit do të ishin të pranueshme, përkundër se kjo nuk ndodhi. Në aktgjykim janë cituar vetëm pjesët e dëshmimeve të dëshmitarëve të dhëna në shqyrtim gjyqësor, dëshmitë e të njëjtëve dëshmitarë, që ata i dhanë në procedurën e hetimeve, u injoruan plotësisht, e të cilët dëshmitarë dëshmuan gjerësisht për ngjarjes, për të cilat akuzohet i pandehuri D.T.. Të 13 dëshmitarët që u dëgjuan në shqyrtimin gjyqësor për ngjarjet në akuzën kundër D.T., të njëjtit dëshmitarë dëshmuan edhe në hetim, por se numri më i madh i dëshmitarëve nuk e përmenden D.T. fare, si pjesëmarrës në ngjarjet në Krushë të Vogël. Vetëm atëherë kur u arrestua D.T., të njëjtit dëshmitarë e kujtuan atë dhe këta dëshmitarë e përmenden si njeriu që vodhi nëpër shtëpitë e fqinjëve dhe që përdhosi kufomat. Përkundër se mbrojtja theksoi në fjalën përfundimtare, por edhe gjatë procedurës së provave të metat në dëshminë e dëshmitarëve specifikisht kujtesën e mëpasshme të tyre, rrethanë kjo që në masë më të madhe i skualifikoj ata si dëshmitar kredibil. Gjykata nuk dha asnjë arsyetim në aktgjykimin në fjalë, por e arsyetoj aktgjykimin nga dëshmitë e këtyre dëshmitarëve në shqyrtim gjyqësor, besueshmëria e të cilave ishte rrëzuar dhe komprometuar plotësisht, për këto rrethana mbrojtja thekson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është prekur me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi që nuk u përmbush detyrimi nga ana e gjykatës që me ndërgjegje të vlerësojë çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë përfundim mbi sigurinë e eksperiencës të një fakti të caktuar, i cili detyrim për gjykatën rrjedh nga neni 361 par.2 të KPP-së. Po ashtu mbrojtja thekson se edhe lidhur me vendimin mbi dënimin përderisa gjykata nuk ka dhënë asnjë arsye përse vendimi mbi dënimin nuk u zbatua sipas ish Kodit Penal të RSFJ, kur ishte në fuqi, por u zbatua kodi i ri në mënyrë retroaktive që ka hyrë në fuqi në janar 2013, e për të cilin kod mbrojtja thekson se është jo i favorshëm për të pandehurin, e që zbatimi i ligjit të pafavorshëm ndaj të pandehurit është shkelje në

procedurën penale, pasi që është shprehimisht e ndaluar, aq më tepër kur gjykata ka dështuar të jap arsye për zbatimin e kodit të ri në aktgjykimin e ankimuar.

b) *Për sa i përket shkeljes së ligjit penal* mbrojtja thekson se shkelja e ligjit penal që rezulton nga neni 385 par.1 pika 1.4 dhe 1.5, ka të bëjë me objektin e akuzës, e që gjykata zbatoi ligjin që nuk është i vlefshëm, e po ashtu është vepruar edhe në raport me vendimin mbi dënim, me çka ka tejkaluar autorizimet që i ka gjykata sipas ligjit.

- Shkelja e ligjit penal në kontekst të kualifikimit juridik të veprës penale ku sipas mbrojtjes rezulton në kualifikimin juridik të veprës penale që u akuzua dhe u dënua D.T., ku është theksuar në kualifikim dispozita e nenit 152 par.2.2 dhe neni 31 i KPK-së. Në këtë kontekst mbrojtja thekson se është shkelur rregulli i zbatimit të ligjit më të favorshëm i paraparë në nenin 3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, që sipas kësaj dispozite është paraparë ndaj kryerësit “zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, në rastin se ligji në fuqi ndryshon para plotfuqishmërisë së vendimit, atëherë ndaj kryerësit zbatohet ligji që është më i favorshëm për kryerësin”. Prandaj, mbrojtja thekson se meqë pretendohet se vepra për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari është kryer në mars të vitit 1999, gjatë kohës së vlefshmërisë së ligjit penal të ish RSFJ, është i përjashtuar zbatimi i Kodit Penal të Kosovës, në rastin konkret, ngase për çdo rrethanë ligji penal i RSFJ është më i favorshëm për të pandehurin, përkundër kësaj gjykate edhe në hyrje edhe në kualifikim të veprave penale thirret në Kodin Penal të Republikës së Kosovës që ka hyrë në fuqi pas kryerjes së veprës penale, në këtë mënyrë gjykata ka shkelur rëndë ligjin penal në dëm të të pandehurit.

- Për sa i përket shkeljes së ligjit penal në raport me vendimin mbi dënimin, mbrojtja thekson se gjykata e shkallës së parë në lidhje me dënimin ka zbatuar Kodin Penal të Republikës së Kosovës e vitit 2013, e që në nenin 152 është paraparë dënimi me burgim nga 5 vite deri në burgim të përjetshëm, e që me rastin e shpalljes gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se dënimi është shqiptuar sipas Kodit Penal, por as në arsyet e dhëna nuk është theksuar se cili ligj është zbatuar në lidhje me vendimin për dënim. Mbrojtja thekson se vepra penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari në nenin 141 të Ligjit Penal të RSFJ-së, ka paraparë dënimin me burgim prej 5 vite ose dënim me vdekje, me kusht që dënimi me vdekje të mund të zëvendësohet me dënim me burgim prej 20 vitesh, por se duke shfuqizuar dënimin me vdekje, UNMIK-u me rregulloren 24/1999, është hequr edhe alternativa e zëvendësimit 20 vite burgim, prandaj dënimi me burgimi është maksimal prej 15 vitesh neni 142 të LPRSFJ. Në këtë kontekst mbrojtja thekson se është edhe praktika e GJEDNJ, për zbatimin e ligjit penal të ish RSFJ-së, ku citon rastin “Maktouf-Damjanović kundër Bosnjës dhe Hercegovinës, ngase sipas mbrojtjes zbatimi retroaktiv i ligjit penal që nuk është i favorshëm për të akuzuarin cenon nenin 7 të KEDNJ-së. Për më tepër mbrojtja argumenton se ligji penal i ish RSFJ në nenin 48 ka paraparë rregullat për matjen e dënimit si dhe dënimin maksimal që mund të shqiptohet në ato raste. Nga të gjitha këto pretendimi i mbrojtjes është se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit D.T., kur është shqiptuar dënimi me burgim prej 22 vitesh.

c) *Lidhur me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike* mbrojtja pretendon se gjykata e shkallës së parë vendimin e marrë e ka bazuar në gjendje faktike të vërtetuar gabimisht në tërësi. Sa i përket pikës I të dispozitivit të aktgjykimit mbrojtja thekson se dëshmitarët kanë ndryshuar deklaratat e tyre që i kanë dhënë në hetime në vitin 2012, e që nuk e kanë shënuar si kryerës të veprës D.T.in, por më vonë në rrjedh të procedurës e kanë ngarkuar të pandehurin. Në raport me deklaratën e dëshmitarit G.Z., mbrojtja thekson se në deklaratën e dhënë nga ky dëshmitar në vitin 2012, ai nuk e ka përmendur D.T.in si kryerës, ndërsa më vonë pas arrestimit të të akuzuarit, dëshmitari ka dhënë edhe dy deklarata ku e ka ndryshuar deklaratën dhe ka thënë se e ka pa të akuzuarin D.T., duke plaçkitur shtëpitë e familjes H.. Në raport me deklaratën e dëshmitarit Sh.A., kur ka dhënë deklaratë në vitin 2012 ky dëshmitar për ngjarjet që kishin ndodhur në fshat, asnjëherë nuk e ka përmendur D.T.in. Më vonë pas arrestimit të të akuzuarit D., dëshmitari në shqyrtim ka deklaruar se e ka parë duke vjedhur. Në raport me deklaratën e dëshmitares D.B., që ka dhënë gjithsej 4 deklarata, mbrojtja thekson se kjo dëshmitare në deklaratën e vitit 2002, 2003 dhe 2013, asnjëherë nuk e ka përmendur D.T., për plaçkitjen e shtëpive të familjes H. dhe kur ka kuptuar dëshmitarja se është arrestuar i akuzuari, ajo ka deklaruar se e ka parë duke plaçkitur. Dëshmitari B.Z. në deklaratën e dhënë në hetime në vitin 2012, nuk e ka përmendur D.T., kur është arrestuar i akuzuari, dëshmitari e ka ndryshuar deklaratën dhe ka thënë se D.T. e ka parë në grup, të cilët i kanë djegur shtëpitë dhe më vonë sërish ky dëshmitar ka theksuar se nuk mund ta precizojë se çka ka bërë D., por askush tjetër nuk ka mundur ta bëjë përveç atyre. Në raport me dëshmitarin A.E. në vitin 2012, ky dëshmitar nuk e ka përmendur D.T.in, e ka përmendur S.T., që është babai i të akuzuarit. Në raport me dëshmitarin K.M. në deklaratën e dhënë në vitin 2012, mbrojtja thekson se asnjëherë ky dëshmitar nuk e ka përmendur D.T.. Më vonë kur është arrestuar i akuzuari, ky dëshmitar e ndërron deklaratën dhe deklaron se D. ka qëndruar në atë mënyrë, sikur e ka vrojtuar situatën, në grup i cili i ka plaçkitur shtëpitë. Në raport me dëshmitarët Xh.M. dhe K.H., mbrojtja thekson se për dëshmitarin Xh.M., ky dëshmitar vetëm pohon që D.T. vetëm ka qëndruar pranë motokultivatorit. Ndërsa, dëshmitari K.H. ka thënë se D.T. i ka vjedhur gjësendet nga shtëpia e tij, këtë e ka parë nga kamioni në lëvizje. Mbi të gjitha këto pretendime të mbrojtjes, për këta dëshmitarë theksohet se nuk mund të rezultojë e provuar fajësia për pikën I të aktgjykimit ndaj të akuzuarit D.T., për faktin se në mënyrë drastike ka ndryshuar deklaratimet dëshmitarët e tyre, me qëllim që i akuzuari të dënohet.

Për sa i përket pikës II të aktgjykimit, mbrojtja thekson se dëshmitarët kanë deklaruar në mënyrë të njëjtë dhe sërish rithekson deklaratimet e ndryshme të dëshmitarëve të dhëna në faza të ndryshme të procedurës më konkretisht për dëshmitarët M.P., T.P., Sh.A., D.B., D. H., Xh.M., K.M., D. H., A.E., A.L., K.H., që mbrojtja thekson se të gjithë këta dëshmitarë në faza të ndryshme të deklarimeve kanë ndryshim të deklaratave dhe kanë mos përputhje për çështjet më të rëndësishme lidhur me faktin se a ka qenë i akuzuari pjesëmarrës tek veprimi siç pretendohet se kamioni me kufoma është shtyrë në lum. Po ashtu, mbrojtja thekson se sa i përket listës së gjetur dhe sa i përket dokumentarëve të shikuar si prova materiale në shqyrtimin gjyqësor, lista ka qenë një listë e tillë që vet serbët e fshatit Krushë ishin organizuar për të bërë roje natën, prandaj ajo listë ka shërbyer dhe asgjë tjetër. Ndërsa, në filmin e dokumentuar të gazetarit britanik, askund nuk është përmendur i akuzuari D.T.. Prandaj, mbrojtja për të gjitha këto prova thekson se nuk mund të vërtetohet fajësia e të

akuzuarit në këtë kontekst nuk rezulton të jetë vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendja faktike mbi provat e tilla, kur dëshmitarët kanë ndryshuar deklaratat e tyre në faza të ndryshme të procedurës.

*d) Lidhur me vendimin mbi dënimin, paushallin gjyqësor dhe kompensimin mbrojtja pretendon se vendimin mbi dënim është në tërësi i gabuar për arsyet që janë theksuar tek pretendimet e shkeljes së ligjit penal.*

Prokuroria Speciale në përgjigje të ankesës thekson:

Nuk është i bazuar pretendimi i mbrojtjes për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke theksuar se ky vërtetim i gabuar ka të bëjë me dëshmitarët jo të besueshëm. Prokuroria thekson se fillimisht dëshmitarët kanë qenë nga fshati ..., të cilët e kanë njohur të akuzuarin D.T. dhe e kanë identifikuar pa asnjë dyshim, si person që ka plaçkitur pronën e familjes H. dhe si person i cili ka përdhosur trupat e pajetë. Se i akuzuari ka plaçkitur pronën e familjes H. është vërtetuar nga deklaratat e dëshmitarit K. H., por edhe të dëshmitarëve të tjerë okularë Xh.M., K.M., Sh.A., A.E., të cilët e kanë parë të akuzuarin D.T., duke plaçkitur pronën e familjes H.. Po ashtu dëshmitarët B.Z. ka deklaruar se D.T., së bashku me disa persona tjerë ka tentuar ti ndezë kamionët e familjes H.. Ndërsa, dëshmitarët G.Z. dhe B.Z., kanë deklaruar se i akuzuari me persona të tjerë janë afruar tek kamionët e familjes H.. Të gjitha këto deklaratat janë bindëse për ngjarjes, duke përshkruar rrethanat në mënyrë të hollësishme, për këto arsye prokuroria pretendon se pretendimet e mbrojtjes janë të pabazuara. Po ashtu edhe sa i përket pikës II të dispozitivit të aktgjykimit, prokuroria thekson se pretendimet e mbrojtjes për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, janë të pabaza, ngase ajo gjendje faktike është vërtetuar nga deklaratat e dëshmitarëve dhe provat materiale.

Prokuroria thekson se pretendimi i mbrojtjes për shkelje të ligjit penal nuk është i bazuar me arsyetimin se meqë vepra penale është e inkriminuar sipas ligjit penal të ish RSFJ-së, e cila vepër penale si dënim minimal për këtë vepër ka paraparë dënimin 5 vjet, ndërsa si dënim maksimal dënimin me vdekje. Duke qenë se pas ngjarjes kritike UNMIK-u, ka shfuqizuar për territorin e Kosovës zbatimin e dënimit me vdekje, ligji penal i ish RSFJ-së, ka paraparë që për dënimin me vdekje, mund të shqiptohet dënimi me burgim deri në 20 vite, përkundër se maksimumi i dënimit të përgjithshëm sipas LPRSFJ-së, ka qenë dënimi prej 15 vite. Në këtë kontekst prokuroria thekson se kur është shfuqizuar dënimi me vdekje auT.tikisht është mbetur si alternativë e dënimit maksimal deri në 20 vite burgim. Për këto arsye, prokuroria thekson edhe vet gjykatat në territorin e Serbisë për veprën e njëjtë penale kanë shqiptuar dënim me burgim prej 20 viteve, e që janë aktgjykimi KBR1823/4 i dt.17.06.2005, KBR4/2018 i dt. 18.06.2009 dhe KBR44/2000 në Gjykatën e Prizrenit ku ka shqiptuar dënim me burgim prej 20 vite. Andaj, për këto arsye prokuroria pretendon se pretendimet ankimore të mbrojtjes janë të pabazuara.

## **Gjetjet e Gjykatës së Apelit**

Gjykata pasi që shqyrtuar pretendimet ankimore dhe përgjigjet në ankesë dhe pasi që vlerësuar ato në kontekst të aktgjykimit të ankimuar dhe pretendimeve të tjera, pasi që ka vlerësuar shkresat e lëndës, ka gjetur se ankesa e mbrojtësve të të akuzuarit është pjesërisht e bazuar.

Lidhur me pretendimet e mbrojtjes për shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 pika 2.1 lidhur me nenin 361 të KPP-së, Gjykata këto pretendime i gjen të pabazuara, për shkak se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të pretenduara nga mbrojtja që lidhen me mos vlerësimin e provave me ndërgjegje dhe në mënyrë të plotë një nga një dhe në lidhshmërinë e tyre nga gjykata e shkallës së parë. Në aktgjykimin e ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka bërë përshkrimet e deklarimeve të deklaratës së K.H. dhe po ashtu ka konstatuar se ky dëshmitar ngjarjet e deklaruara i ka parë vet e ka njohur të akuzuarin dhe po ashtu gjykata ka konstatuar se ia ka falur besimin dëshmisë së dëshmitarit, duke theksuar se kjo deklaratë është në harmoni me dëshmitë e dëshmitarëve B.Z., K.M., Xh.M., Sh.A., D.B., D. H., A.E. dhe provat materiale, arsyetim ky i dhënë në faqen 8 të aktgjykimit. Po ashtu për dëshmitarin B.Z., gjykata ka dhënë arsyet për provën e tillë dhe për sa i përket besimin të kësaj deklarate, ku ka konstatuar se kësaj deklarate ia ka falur besimin dhe kjo deklaratë është në harmoni me dëshminë e dëshmitarëve K.H., K.M., Xh.M., Sh.A., D. H., A.E. dhe provat tjera, arsyetim ky i gjykatës në faqen 9. Ndaj deklaratës së dëshmitarit K.M., gjykata po ashtu ka arsyetuar se ia ka falur besimin kësaj deklarate, ngase e njëjta është në harmoni me dëshminë e dëshmitarëve K.H., B.Z., Xh.M., Sh.A., D.B., D. H. dhe A.E. dhe po ashtu me provat materiale. Edhe ndaj deklaratës së Xh.M.t dhe D.B., Sh.A., G.Z., T.P., D. H., A.E., A.L., D. L., D. H., M.D., B. L., F.I., Q.Sh., J.S., për të gjithë këta dëshmitarë, gjykata e shkallës së parë në arsyet e dhëna nga faqja 10 gjer në faqen 21, përveç se ka arsyetuar pse ia ka fal besimin deklaratave të tyre, po ashtu ka arsyetuar se këto deklarata janë të ndërlidhura me njëra tjetrën dhe njëkohësisht, gjykata në raport me deklaratën e secilit prej këtyre dëshmitarëve, ka arsyetuar me rastin e analizimit të deklaratave, se cilat fakte rezultojnë të provuara nga deklaratat e dëshmitarëve. Në këtë aspekt, as Gjykata e Apelit nuk i gjen të bazuara pretendimet e mbrojtjes së të akuzuarit, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës penale, ngase nuk ka analizuar provat një nga një dhe në lidhshmërinë e tyre.

Më në detaje, për përputhshmërinë e këtyre provave, kjo gjykatë do të japë arsye kur të elaborohen pretendimet e mbrojtjes në raport me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, ku mbrojtja ka theksuar se dëshmitarët e dëgjuar, kanë ndryshuar deklaratat, duke e ndërlidhur këtë pretendim me shkelje esenciale, që gjykata nuk i ka vlerësuar ato sipas nenit 361 të KPP-së.

### ***Pretendimet lidhur me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike***

Në radhë të parë, Gjykata e Apelit pretendimet e mbrojtjes nuk i gjen të bazuara se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabueshme.



Si çështje të kontestuara që rezultojnë nga shkresat e lëndës, por edhe nga pretendimet ankimore, janë: a ishte i akuzuari person i uniformuar gjatë periudhës së marsit të vitit 1999 që shërbente në forcat policore, apo ushtarake siç është konstatuar nga gjykata e shkallës së parë si pjesë rezervë e atyre forcave, a ishte i akuzuari personi që kishte marrë pjesë në konfiskim, plaçkitje, shkatërrim të paligjshëm dhe të qëllimshëm të pasurisë, që nuk justifikohet me nevoja ushtarake, a ishte i akuzuari që kishte marrë pjesë në marrjen e pasurisë së automjeteve, makinave bujqësore dhe sendeve të tjera, me vlerë që i përkisnin K.H. dhe anëtarëve tjerë të familjes H.. Po ashtu, si fakt kontestues ishte se a ishte i akuzuari personi që kishte marrë pjesë në përdhosjen e trupave të pajetë të një numri personash të paidentifikuar, duke i djegur ata trupa të pajetë në mënyrë të paligjshme, ose duke kërkuar shkatërrimin e tyre, duke i hedhur ata në mënyrë të pahijshme në lum.

Edhe për Gjykatën e Apelit, siç ka gjetur gjykata e shkallës së parë këto rrethana të fakteve kontestuese rezultojnë të provuara me provat që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor.

Sa i përket pretendimeve në raport me deklaratat e dëshmitarëve, ku mbrojtja vë theksin në tri çështje kontestuese të këtyre deklaratave, se përjashtimisht njëri nga dëshmitarët K.H., asnjëri nga dëshmitarët e tjerë nuk e kishte përmendur të akuzuarin D.T., këta dëshmitarë në shqyrtim gjyqësor kishin ndryshuar deklaratat dhe e kishin përmendur në shqyrtim gjyqësor, përkatësisht kur ishte arrestuar i dyshuari, dhe po ashtu kredibilitetin e dëshmitarëve.

Gjykata e Apelit gjen se dëshmitari K.H. në deklaratën e vitit 2012 të dhëna para prokurorit, e përfshinte të akuzuarin D.T. dhe ai në këtë deklaratë ka pohuar këto rrethana: se i akuzuari ishte i uniformuar me uniformë të policisë, se të akuzuarin e kishte parë duke nxjerrë gjërat nga shtëpia e tij së bashku me personat tjerë dhe duke i vendosur ato në mjet transportues, më saktësisht në traktor, për të gjitha këto rrethana dëshmitari e kishte pohuar edhe në shqyrtimin gjyqësor, po ashtu dëshmitari thekson në deklaratat në fazën e hetuesisë dhe në shqyrtimin gjyqësor edhe këto rrethana, se automjetin e tij kamionin dhe gjërat e tjera të shtëpisë së tij, kur ishte kthyer pas përfundimit të luftës nga Shqipëria, ato i kishte gjetur në shtëpinë e të akuzuarit.

Sa i përket dëshmitarit G.Z., që mbrojtja pretendon se ai nuk e përfshinte të akuzuarin D.T., në deklarinimin e tij në fazën e hetimeve, kjo Gjykatë gjen se ky dëshmitar në fazën e hetimeve ka pohuar këto rrethana, në raport me të akuzuarin *“Pamë serbët që vinin të merrnin kamionët që i takonin familjes H., S.T. dhe vëllain e tij D.T., pashë edhe të tjerë që nuk i njoh, ata kishin aftësi mekaniku dhe mund ti nisnin kamionët, kur u kthye nga Shqipëria, dy kamionët që ata përpiqeshin ti nisnin ishin zhdukur”*. Po ashtu, ky dëshmitar pohon në deklaratën e vitit 2012 se *“Dua të theksoj që çdo ditë mund të shihje tymin që dilte në skaj të Drinit, ne mund të shihnim piring të madh dhe menduam se ishte lloj i traktorit, po nuk ishte ajo, por një kamion i mbushur me trupa që digjej çdo ditë”*. Ky dëshmitar edhe në vitin 2018 për këtë rrethanë ka pohuar, të gjitha këto rrethana i ka pohuar ky dëshmitar edhe në shqyrtimin gjyqësor.

Për sa i përket deklaratës së dëshmitares D.B., Gjykata vlerëson pretendimet e mbrojtjes, por ato i gjen si të pabazuara, pasi që edhe kjo dëshmitare pohon faktin se e ka parë nga matanë lumit Dri, përmes dylbive, kur D.T. kishte qenë prezent te kamioni që ishte shtyrë në ujë me kufoma, të njëjtat rrethana kjo dëshmitare i kishte pohuar edhe në shqyrtimin gjyqësor, por fakt i provuar që e pohon kjo dëshmitare se ishin përdorur dylbitë për vëzhgim, rezultojnë edhe deklaratat e dëshmitarëve tjerë në këtë çështje penale.

Sa i përket dëshmitarit B.Z., ky dëshmitar kishte dhënë deklaratë në fazën e hetimeve para prokurorit dhe po ashtu rezulton nga deklarata e këtij dëshmitari që D.T. ishte me uniformë, *“Se me datë 25 mars ata i kanë plaçkitur shtëpitë, ata i kanë djegur të gjitha ato shtëpi, e kam parë S.N., pastaj S.T., M.T., D.T. dhe gjithë të tjerë, i kam parë ata duke i vënë zjarr”*. Të njëjtat rrethana i ka pohuar edhe në shqyrtimin gjyqësor.

Sa i përket dëshmitarit A.E., ky dëshmitar në deklaratën e dhënë në prokurori në vitin 2012, se *“Me datën 26 qershor pata mundësi që të shoh një kamion me ngjyrë portokalli Mercedes 508 që vinte nga Krusha e Madhe, te uji që është në Krushë të Vogël, siç dukej duke shkarkuar njerëz – trupa, nga kamioni dhe duke i hedhur ata aty, derisa ata po i shkarkonin, unë pata mundësi që të shoh flakën duke dal nga trupat e tyre, me datën 26 qershor rreth orës 4:30, kamioni ishte sjellë tek lumi Dri, nga Sr. dhe dy djemtë e tij St. dhe D., pastaj traktori u kthye mbrapsht që ishte me lugë ngarkuese, i cili e shtyu kamionin pranë lumit, ky kamion u djeg për tri ditë, unë e kam parë këtë me sytë e mi, kam dëgjuar edhe të shtëna, por nuk kam mundur të shohë se kush ka shtënë, në fakt unë i pashë ata tretë, duke shtënë në kamion, deri sa kamioni mori zjarrin”*, rrethana të tilla ky dëshmitar i ka pohuar edhe në shqyrtimin gjyqësor.

Sa i përket dëshmitarit Sh.A., në deklaratimet e tij në hetuesi pohon rrethanat se janë larguar nga shtëpitë dhe po ashtu pohon rrethanat se kishte shkuar me dy fshatarë të tij, për të iu ndihmuar grave dhe fëmijëve dhe se nga ato kishte dëgjuar emra të serbëve që kishin ndërhyrë në fshat, ndërsa lidhur me faktin se a e kishte parë ai dikë nga fqinjët serb në fshat, në të vërtetë ky dëshmitar nuk e pohon emrin e të akuzuarit, por thekson se nuk kam mundur që t'i shohë pasi që ne jemi më poshtë, ndërsa lidhur me kamionin që kishte shkuar në lumin Dri, ky dëshmitar thekson se aty ishin policia me tesha të zeza, ndërsa në shqyrtim gjyqësor ky dëshmitar deklaroi për disa nga këto rrethana dhe thekson se *“Kur ka ardh kamioni, ka ardhur rrugës për në Prizren dhe është kthyer për në Dri, ka qenë kamion 508 ngjyrë portokalli dhe një kombi dhe kanë ardhur deri në breg Dri, kamioni u shihke që ka pasur peshë, ne jemi interesuar që mos po vjen ndonjë mashkull i fshatit, kemi dal dhe kemi shikuar kjo ka ndodhur me datën 27 mars, kur kemi dalë kemi pa policë me uniforma, ka zbritur D.T., S.N., K. emri nuk po më kujtohet dhe një person S.T., janë munduar që ta shtin kamionin në Dri, kanë shprazur njerëz kufoma prej kombit, njëri nga ta e ka ndezë traktorin dhe e ka shtyrë me traktor, kamioni ka mbetur pjerrët, kanë gjuajtur diçka të bardhë dhe e kanë kallur kamionin, pasi që ka filluar të digjet kamioni kanë filluar të shtënë në breg Dri, pjesa ku kemi qenë, ne e kemi përcjellë edhe me dylbi, aty ka qenë T. i ka pasur dylbitë”*.

Po ashtu edhe deklaratat e dëshmitarëve të tjerë të kontestuar nga mbrojtja, rrethanat e tilla, rrethana të tilla i pohojnë si në fazën kur deklarohen në hetuesi e po ashtu edhe në shqyrtim gjyqësor.

Nga të gjitha këto prova, që të gjithë këta dëshmitarë kishin përjetuar ngjarjen e tillë, pra që nënkupton që ishin dëshmitarë okularë, në të vërtetë rezultojnë të provuara faktet e theksuara si më lartë, se i akuzuari D.T. rezulton të ketë qenë i uniformuar, për Gjykatën nuk ka asnjë rëndësi në kuptim të përgjegjësisë penale apo në kuptim të lartësisë së dënimit fakti se ai ishte i uniformuar si pjesë rezervë në forcat e policisë apo të ushtrisë, është e mjaftueshme që nga të gjitha dëshmitarët pohohet dhe vërtetohet kjo rrethanë, se i akuzuari ishte i uniformuar.

Nga deklaratat e dëshmitarëve po ashtu provohet fakti se i akuzuari kishte marrë pjesë në veprime të bashkëkryerjes me të dyshuarit tjerë, në marrjen e sendeve të të dëmtuarve, më saktësisht në konfiskimin, plaçkitjen dhe shkatërrimin e pasurisë. Lidhur me faktin, se a kemi të bëjmë me vjedhje në shkallë të gjerë të pasurisë që nuk justifikohet me nevoja ushtarake, bazuar në deklaratat e dëshmitarëve, që provohet fakti se sendet që ishin plaçkitur dhe sendet që ishin shkatërruar si pasuri nuk ishin për nevoja ushtarake, ndërsa kategorizimi i shkallës së gjerë të pasurisë në kontekst të ngjarjeve rezulton si i tillë për arsye se nuk bëhet fjalë për marrjen e një sendi, por siç rezulton nga provat – deklaratat e dëshmitarëve, nga të gjitha shtëpitë, vetëm 6 nga to, nuk ishin shkatërruar, ndërsa siç rezulton nga deklaratat e dëshmitarëve ishin marrë gjëra në shtëpitë e tyre – sende të luajtshme si televizion, frigorifer, tepiha dhe krevat, pastaj po ashtu ishin marrë automjetet, makineritë bujqësore dhe sendet tjera me vlerë. Të gjitha këto, rezultojnë që përbëjnë shkallë të gjerë të pasurisë, ngase nuk mund të kategorizohet veprimi i tillë kur në të vërtetë nga rrethanat e fakteve, rezulton se i akuzuari ishte në bashkëkryerje me personat e tjerë, gjë që ky fakt se ai vepronte në bashkëkryerje provohet edhe me listën që kishte mbetur, pas tërheqjes së forcave serbe, në të cilën listë kategorizoheshin grupet e personave, e ku emri i të akuzuarit renditej në grupin 1. Po ashtu, nga deklaratat e dëshmitarëve, provohet fakti se ishte i akuzuari D.T. që kishte marrë pjesë në bashkëkryerje me personat e tjerë, kur ishte vepruar me kamionin në të cilin ishin bartur trupat e të vdekurve, e kjo rrethanë përveç se me deklaratat e dëshmitarëve të pjesëmarrjes të akuzuarit, provohet edhe me provat materiale dhe atë dokumentarin e administruar si provë që kishte incizuar gazetari britanik dhe deklaratën e tij, por edhe raporti i zhvarrosjes nga UNMIK-u, numër 0023/inv/03, nga i cili është konstatuar varr masiv me djegien e disa trupave, këto mbetje janë gjetur pranë lumit Dri, në një kamion, të cilit i është vënë flaka bashkë me eshtrat janë gjetur edhe gurët e shtëpisë së Q.B. në kamion.

Për të gjitha këto arsye, Gjykata i gjen si të pabazuara pretendimet ankimore të mbrojtjes sa i përket shkeljes së dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.

Gjykata njëkohësisht ka parasysh një fakt për sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike që mbrojtja e konteston, gjendje faktike kjo që është konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, se i akuzuari i ka ndërmarrë këto veprime në bashkëkryerje. Në këtë kontekst, kjo Gjykatë bazuar në provat që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor, vlerëson se është vërtetuar

pjesëmarrja e të akuzuarit si bashkëkryerës në veprën penale për të cilën, kjo Gjykatë ka konstatuar si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e Apelit vetëm një fakt të pretenduar faktik e ka gjetur se nuk është i mbështetur me prova, si i tillë fakti është “...dhe ose fshatrat tjerë të Kosovës...”, duke qenë se asnjë nga dëshmitarët nuk kanë pohuar ta kenë parë të akuzuarin D.T., të ketë ndërmarrë ndonjë veprim që kategorizohet si veprim inkriminues nga neni 142 jashtë fshatit Krushë të Vogël, kjo Gjykatë vlerëson se për këtë rrethanë faktike nuk ka prova që dëshmojnë veprimin e të akuzuarit. Mbi këtë bazë, Gjykata e Apelit sa i përket këtij fakti e ka konstatuar në dispozitivin e aktgjykimit, për këtë arsye ky fakt si i tillë nuk është pjesë e dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Marrë për bazë rrethanën se vepra penale e krimeve të luftës nga neni 142 ka disa forma të kryerjes dhe meqenëse format tjera të veprimit kryerës të të akuzuarit D.T., rezultojnë të provuara, siç u argumentua më lartë, por meqë për faktin e konstatuar se nuk mbështetet me ndonjë provë, si i tillë ky fakt nuk i cenon në tërësinë e saj figurën e veprës penale për të cilën kjo Gjykatë ka konstatuar në dispozitiv, për këto arsye Gjykata vetëm ka konstatuar se ky fakt është i pa mbështetshëm në prova dhe nuk mund ti atribuohet si veprim brenda tërësisë së veprimeve të akuzuarit D.T..

#### ***Pretendimeve ankimore lidhur me shkeljen e ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin***

Kjo Gjykatë, ka gjetur si të bazuar pretendimet e mbrojtjes sa i përket shkeljes së ligjit penal në kontekst të faktit se cili ligj duhet zbatuar, në kontekst të kualifikimit juridik të veprës penale, të cilat reflektojnë edhe në vendimin mbi dënim.

Duke qenë se gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar, kishte shqiptuar ndaj të akuzuarit dënimin për dy vepra penale si dënim unik prej 22 vitesh, rezulton se cilësimi juridik i këtyre veprave penale ishte bërë sipas dy ligjeve Kodit Penal të ish RSFJ-së, dhe Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ndërsa në arsyet e dhëna për lartësinë e dënimit, por edhe në shqiptimin e dënimit unik, rezulton se gjykata ka zbatuar dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Kjo Gjykatë, vëren se sipas Kodit Penal të RSFJ-së, dënimi më i ulët për veprën penale krimet e luftës kundër popullsisë civile nga neni 142 është me burgim deri në 5 vite, deri në dënim me vdekje, meqë në Kosovë, dënimi me vdekje ishte shfuqizuar nga UNMIK, bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit Penal të RSFJ-së në nenin 38 par. 2, është paraparë se për veprat penale për të cilat është parashikuar dënimi me vdekje, gjykata mund të japë edhe dënimin me burgim deri në 20 vite, që rezulton se dënimi maksimal për këtë veprë penale sipas këtij Ligji, mund të shqiptohet deri në 20 vite, kjo për faktin se Rregullorja e UNMIK-ut që kishte shfuqizuar dënimin me vdekje në territorin e Republikës së Kosovës, nuk kishte ndryshuar asnjë efekt të lartësisë së dënimit me burgim, që mund të shqiptohet kur për atë veprë ishte paraparë dënimi me vdekje. Ndërsa, Kodi Penal i Republikës së Kosovës në nenin 152 ka paraparë dënimin me burgim prej së paku 5 vjet ose me burgim të përjetshëm, çka nënkupton

se Kodi Penal nuk është kod më i favorshëm për të akuzuarin. Për më tepër, dispozitat kushtetuese përcaktojnë në mënyrë shprehimore se ndaj të akuzuarit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, përveç kur ligji i ndryshuar është më i favorshëm ndaj të akuzuarit. Mbi këtë bazë, kjo Gjykatë gjen se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar Kodin Penal të Republikës së Kosovës, në cilësimin juridik të veprave penale.

Megjithatë, Gjykata e Apelit duke pas për bazë faktin se bëhej fjalë vetëm për zbatimin e ligjit penal që detyrimisht duhet zbatuar ai që është më i favorshëm për të akuzuarin, e duke gjetur se shkelja e tillë e ligjit penal mund të revidohet nga kjo Gjykatë, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, ku ka zbatuar ligjin penal të Jugosllavisë, që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.

Sa i përket faktit të cilësimit të dy veprave penale që gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, kjo Gjykatë e ka ndryshuar aktgjykimin e tillë për faktin se vlerëson se kemi të bëjmë me një veprë penale, ngase rezulton se veprimet e tilla të ndërmarra nga i akuzuari që kanë të bëjnë me konfiskimin e pasurisë, plaçkitjen në shkallë të gjerë, marrjen e sendeve – të makinerisë bujqësore dhe makinave tjera dhe përdhosjen e trupave që cenojnë dinjitetin njerëzor, si veprime të tilla janë të ndërmarra në kuadër të veprës penale nga neni 142 i LPRSFJ-së, për të cilën dispozitë janë të zbatueshme Konventat e Gjenevës dhe protokollet shtesë, më konkretisht në kohën e kryerjes së veprës penale ish RSFJ-së, këto Konventa i kishte miratuar më saktësisht Konventat e Gjenevës të dt. 12 gusht 1949, janë ratifikuar nga (ish RSFJ) me 21 prill 1950 dhe kanë hyrë në fuqi me 21 tetor 1950, ndërsa Protokollet shtesë që kanë hyrë në fuqi me 26 dhjetor 1978, në të njëjtat Protokolle ish RSFJ, u bë palë me 11 qershor të vitit 1979, çka konsiston se në përputhje me nenin 141 ku inkriminohet vepra penale, e cila dispozitë ishte e zbatueshme në Kosovë në kohën e kryerjes së veprës penale, por edhe Konventa dhe Protokollet ishin të zbatueshme në Kosovë. Prandaj, Gjykata gjen se nuk kemi të bëjmë me dy vepra penale, por me veprime të tërësishme, që si të tilla konsumojnë elementet e veprës penale për të cilën kjo Gjykatë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.<sup>1</sup>

### ***Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit.***

Sa i përket dënimit, kjo Gjykatë matjen e dënimit e ka mbështetur në nenin 41 të ish LPSRFJ-së, ku nga rrethanat e çështjes, por edhe nga shkresat tjera të lëndës ka vlerësuar rrethanat rënduese dhe lehtësuese në këtë kontekst. Si rrethana rënduese gjykata ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale, ku rezulton nga tërësia e rrethanave se i akuzuari kur kishte vepruar në kryerje të kësaj veprë penale i kishte ndërmarrë brenda dy ditëve të tërësishme dhe në rrethanat që për të dëmtuarit ishin shumë të rënda, motivin për shkakun e kryerjes së kësaj veprë penale, po ashtu gjykata e ka gjetur si rrethanë rënduese, e që rezulton se në të vërtetë motivi ishte vetëm për shkak të aspektit të fillimit të luftës dhe që veprimet e të akuzuarit

---

<sup>1</sup> Komentar Krivicnog Zakona Socialisticke Federativne Republike Jugoslavije, Botim i “Savremena Administracija”, viti 1978, faqe 500.

ishin të drejtuara ndaj një grupi të caktuar etnik – shqiptarë. Kjo qartë reflekton nga provat që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor, ngase siç rezulton i akuzuari nuk kishte asnjë mosmarrëveshje apo konflikt me cilindo nga fshatarët e tij para fillimit të luftës, si rrethanë rënduese po ashtu gjykata gjen rrethanat në të cilat ishte kryer vepra penale, e që rezulton se veprimet e të akuzuarit ishin ndërmarrë kur ndaj të dëmtuarve ishte urdhëruar largimi dhe lëshimi i shtëpive, por se në të njëjtën kohë, shumë nga fshatarët ishin ndalë, ndërsa përveç fëmijëve dhe grave ishin lejuar që të vazhdojnë tutje. Të gjitha këto i përbëjnë veprimet e të akuzuarit që të vlerësohen si rënduese në kontekst të rrethanave të kryerjes së veprës penale. Po ashtu si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar edhe faktin se siç rezulton nga rrethanat e fakteve të cilat mbështeten me provat, i akuzuari kishte vepruar në bashkëkryerje, që është e qartë se veprimet që i ndërmerre i akuzuari krijonin edhe pasojën për të dhe bashkëkryerësit.

Si rrethana lehtësuese, Gjykata ka vlerësuar rolin e të akuzuarit në veprimet e bashkëkryerjes e që rezulton se i akuzuari nuk ishte me rol kryesor, për faktin se nuk shpërfaq asnjë provë apo rrethanë se ky i akuzuar udhëhiqte apo urdhëronte bashkëkryerësit, çfarë nënkupton se roli i tij në kuadër të bashkëkryerjes nuk ishte në rolin e udhëheqësit të veprimeve inkriminuese, rrethanë tjetër lehtësuese e ka vlerësuar jetën e mëparshme të kryerësit, e që nga provat që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor, të gjithë dëshmitarët pa përjashtim pohojnë faktin se raportet ndërmjet kryerësit dhe tyre në fshat kanë qenë të mira, por ato janë keqësuar në kohën e luftës, nga ana tjetër nuk ka ndonjë të dhënë në shkresat e lëndës se i akuzuari të ketë qenë kryerës i ndonjë vepre penale për të vlerësuar cilësitë personale që mund të manifestohen si elemente të dhunshme të personalitetit. Rrethanë tjetër lehtësuese, Gjykata ka vlerësuar faktin se i akuzuari në kohën e kryerjes së veprës penale ishte në moshë relativisht të re, që ishte i moshës 26 vjeçare. Të gjitha këto rrethana, Gjykata ka marrë për bazë kur ka caktuar dënimin ndaj të akuzuarit, duke qenë e bindur se do të arrihet qëllimi i dënimit sipas nenit 33 të LPSRFJ.

Për të gjitha këto arsye kjo gjykata i gjen të bazuara pretendimet e mbrojtjes për sa i përket shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin, andaj edhe e ka aprovuar pjesërisht ankesën e mbrojtjes së të akuzuarit.

Sa i përket pretendimeve për shpenzimet procedurale, mbrojtja nuk thekson asnjë arsye përveç që i konteston ato, kjo Gjykatë vlerëson se pretendimet e tilla janë të pabazuara nga faktin se marr për bazë kohëzgjatjen, ndërlikueshmërinë e çështjes dhe faktin se për një kohë të gjatë ishte vepruar nga organe e ndjekjes për sigurimin e të akuzuarit, të gjitha këto arsyetojnë plotësisht shpenzimet e tilla të procedurës, për ca i përket paushallit gjyqësor. Ndërsa sa i përket pretendimit për kërkesën pasurore juridike nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit ngase të dëmtuarit në këtë çështje janë udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Andaj, për të gjitha këto arsye, Gjykata e Apelit konform nenit 403 par. 1 nën par. 1.2 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**DEPARTAMENTI SPECIAL**  
**APS.nr.37/2020 me datë 30.11.2020**

**Bashkëpunëtori Profesional**

**Anëtarët e kolegjit**

**Kryetari i kolegjit**

---

**Bajram Rexhahmetaj**

---

**Burim Ademi**

---

**Kreshnik Radoniqi**

---

**Milan Bigović**



## РЕПУБЛИКА КОСОВО / REPUBLIKA E KOSOVËS

Në përputhje me nenin 398 paragrafi 4 të KPPK-së, parashtroj:

Mendim i veçuar në çështjen penale të të akuzuarit D [REDACTED] T [REDACTED] APS (KZS) nr. 37/20 të dt. 30.11.2020.

### Arsyetim

I akuzuari D [REDACTED] T [REDACTED] me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren P.nr. 35/18 të 22.06.2020 i dënuar me dënimin unik burgosje në kohëzgjatje prej 22 vitesh për dy vepra penale të kryera në bashkëkryerje sipas nenit 142 në lidhje me nenin 22 të KP të RSFJ, në lidhje me nenin 152 paragrafi 2 pika 2.2 në lidhje me nenin 31 KPK, në lidhje me nenin 3 (C) të Konventës së Gjenevës të 12.08.1949, nenin 4 dhe Protokollint të dytë të 08.06.1977 dhe Ligjin dhe Normat e së Drejtës Ndërkombëtare Zakonore.

Konsideroj se aktgjykimi i shkallës së parë ka mangësi faktike dhe juridike dhe se si i tillë nuk mund të qëndrojë, respektivisht duhet të anulohet-hidhet poshtë dhe t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim dhe vendosje.

### Çështjet juridike në lidhje me pikën I të Aktgjykimit

Në dispozitivin e aktgjykimit është theksuar se këtu i akuzuari mori pjesë në konfiskimin e pasurisë, plaçkitje dhe shkatërrim të paligjshëm të pronës (djegia e shtëpive) dhe vjedhje të **shkallës së gjerë (sasisë së madhe)**, që paraqet tipare të veprës penale për të cilat këtu i akuzuari është dënuar, ndërsa kjo në dispozitiv nuk tregohet nuk mjafton vetëm të thuash "shkallë të gjerë" por ishte e domosdoshme që të caktohej konkretisht vlera e përafërt e pronës së dëmtuar, të marrur dhe ngjashëm të vlerësohej përafërsisht numri ose vlera nominale e së njëjtës dhe nuk mjafton vetëm të theksohet shtëpia që i përkiste të dëmtuarit K [REDACTED] H [REDACTED] dhe anëtarëve të tjerë të asaj familje dhe vetëm gjërat që u përkisnin atyre, sepse kjo nuk e bën shkallën apo sasinë e madhe. Për një krim kaq të rëndë, faktet rreth "shkallë të gjerë" duhej të përcaktoheshin



Kryerësi i këtij krimi mund të jetë çdo person, madje civil, dhe nuk ka pse të identifikohet si anëtar i ndonjë formacioni ushtarak, policor ose paraushtarak, por nuk mund të caktohet "ose" "i këtij apo atij formacioni, dhe kështu të supozohet statusi i tij si kryerës, siç thuhet në aktgjykimin e kundërshtuar dhe kjo gjithashtu përbën shkelje të nenit 384 paragrafi 1 nënparagrafi 1.12 në lidhje me nenin 370 paragrafi 4 dhe në lidhje me nenin 365 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPPK.

### **Gjendja faktike lidhur me pikën I të Aktgjyimit.**

Lidhur me gjendjen faktike të vërtetuara, rrjedhë qartazi kundërthënia në mes të dispozitivit dhe arsytimit në lidhje me pjesëmarrësit dhe veprimet e këtu të akuzuarit. Në dispozitiv thuhet se i akuzuari dhe persona të tjerë të paidentifikuar, ndërsa në arsyetim përmenden emrat e babait të tij S. [redacted] vëllait S. [redacted] dhe një personi të quajtur "Keko", se deklaratat e dëshmitarëve gjithashtu ndryshojnë në lidhje me veprimet e kryera të konfiskimit të pronës në dispozitiv në raport me arsyetimin ku flitet vetëm për marrjen dhe jo për djegie dhe shkatërrim. Nga deklaratat e të gjithë dëshmitarëve në lidhje me veprimet e të akuzuarit, nuk ishte vërtetuar qartë se i akuzuari e bëri atë në "shkallë të gjerë".

Kontradikta e dëshmimeve të dëshmitarëve reflektohet në ndryshimin e deklaratave në shqyrtimin kryesor gjyqësor në raport me deklaratat e dhëna në procedurën paraprake, të cilat nuk përmenden fare në aktgjykimin e kundërshtuar dhe të cilat janë thelbësore për përcaktimin e besueshmërisë së këtyre dëshmitarëve dhe të theksuara me të drejtë në pretendimet ankimore dhe në atë mënyrë, gjykata e shkallës së parë nuk arriti të vlerësojë në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha provat nga procedurat e mëparshme dhe pastaj, në bazë të të gjitha provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor, të analizozi plotësisht të gjitha ato dhe të bëjë një konstatim të saktë në lidhje me ekzistencën e padyshimtë të fakteve të caktuara.

### **Çështja juridike në lidhje me pikën II të Aktgjyimit**

Sipas mendimit tim, veprimet të cilat të akuzuarit i vihen barrë dhe të përshkruara në pikën II të aktgjyimit nuk parashikohen në nenin 142 të KP të RSFJ, as në Konventën e Gjenevës në lidhje me Mbrojtjen e personave civilë në kohë luftë, e miratuar në 12.08.1949 dhe Protokollin e Konventës së Gjenevës të vitit 1977. Me këto rregullore është paraparë mbrojtja e popullatës civile, respektivisht si objekt mbrojtës janë popullata civile, të burgosurit e luftës dhe të plagosurit, prona e një popullate më të madhe civile dhe veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale kanë të bëjnë me këta persona, vlerat e tyre njerëzore dhe pasurinë. Askund si veprime inkriminuese nuk janë përcaktuar raporti, sjellja dhe si vijon ndaj të ndjerëve që ranë - u vranë në krime që në rastin konkret ishin kryer nga persona të tjerë. Në shkresat e lëndës në mënyrë të pakontestueshme qëndron se krimi i tmerrshëm ndodhi në fshatin Krushë e Vogël më 26.03.1999, por që në ato krime i akuzuari D. [redacted] T. [redacted] nuk mori pjesë. Në një gjendje të tillë gjërat që rrjedhin nga shkresat e lëndës, unë jam i mendimit se veprimet e të akuzuarit këtu në këtë pjesë

vend të ngjarjes gjeti dhe filmoi kamionin në fjalë, pa gjetur asnjë nga gjurmët e treguara nga dëshmitarët e përmendur, ose dëmtimin e të njëjtit nga zjarrvënia, përveç gjakut të tharë në rimorkion e kamionit, gjë që rrit më tej dyshimet në lidhje me besueshmërinë e dëshmitarëve, si dhe jologjikshmërinë në deklaratat e shumicës së dëshmitarëve se ata panë trupat e pajetë të njerëzve edhe nëse rimorkio e kamionit ishte e mbuluar me një pëlhurë gomuar e gjetur pas luftës e padëmtuar nga zjarrvëniet pranë kamionit.

Poashtu është problematike që gjykata e shkallës së parë ka pranuar një listë që u gjet pas ngjarjeve në shtëpinë e banorit S. N. sepse nga i njëjti nuk mund të nxjerrë një përfundim në lidhje me statusin e të akuzuarit këtu dhe banorëve të tjerë të fshatit Krushë e Vogël. Kjo listë në vetvete nuk përfaqëson faktin se personat në atë listë janë anëtarë paraushtarak ose ndonjë formacioni tjetër, dhe kjo konfirmohet nga pohimi i Prokurorisë se kjo listë përfaqëson vetëm personat që ruanin fshatin, gjë që është rrjedhë logjike në ngjarje lufte. Askund në atë listë nuk përmendet statusi i tyre, armët, armët që ata mund të kenë pasur dhe veprimi, dhe prandaj i njëjti për mendimin tim është i parëndësishëm dhe sigurisht jo vendimtare dhe me rëndësinë që i është dhënë nga gjykata e shkallës së parë.

Lidhur me zbatimin e ligjit në fuqi dhe shqiptimin e dënimit unik të burgimit, dhe para qëndrimit unanimit të Kolegjit, dua të theksoj se gjykata e shkallës së parë bëri shkelje absolute të të drejtës materiale. Është e pakontestueshme që duhet të zbatohet ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale e kjo është viti 1999, dhe se vetëm vendimi ligjor për zbatimin e një ligji tjetër është vetëm në situatën që është më e favorshme për kryesin e veprës, e cila është një nga parimet themelore të ligjit penal pozitiv, dhe e rregulluar me KP e mëhershëm të RSFJ nga neni 4 paragrafi 2, por gjithashtu të vlefshme edhe me KPRK e tanishëm neni.3 paragrafi 2 .

Nga të gjitha sa u prezentuan më sipër, konsideroj që aktgjykimi i shkallës së parë nuk mund të qëndroj, për këtë arsye jam i mendimit që ky aktgjykim duhet të hidhet poshtë dhe të kthehet për rigjykim dhe vendojë, dhe që mendimi im i veçuar **t'i bashkangjitet vendimit kryesor.**

Prishtinë

ANËTARË I KOLEGJIT - GJYQTARI

Më 30.11.2020

Milan Bigović

Përktheu: Dhurata Prokshi

